

VENDIM
Nr.119, datë 28.12.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC DRAGOSHTUNJË” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, të neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 4 pika 1 germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, të nenit 18 pika 1 germa “a” të rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC Dragoshtunjë” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC Dragoshtunjë” sh.p.k. plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikën 4.1.5 të nenit 9, përkatësisht me miratimin nga “CEZ shpërndarja” (OSSH) të pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes, është në proces miratimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “HEC Dragoshtunjë” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Zanore”, “Dragoshtunjë”, “Sheja” dhe “Ura”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta